

KËRKESË
Nr. 521, datë 17.1.2018

PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA “NDËRTIM I RI I SHKOLLËS TIP 1 + TIP 4, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 9, SHESHI 9/1”

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga “Ndërtim i ri i shkollës tip 1 + tip 4, në Njësine Administrative nr. 9, sheshi 9/1”. Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për pronarët sipas listës emërore më poshtë. Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë), me adresë: Rruga e Durrësit, nr. 23, Tiranë.

ZËVENDESMINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini

ZËRI KADASTRAL: AKTIVITETI PRIVAT, SHITËPI BANIMI ETJ., QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT "NDËRTIMI I RI I SHKOLLËS TIP 1 + TIP 4 NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 9, SHESH 9/1", ME ZHVILLUES, BASHKIA TIRANË

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe e tokës bujqësore (arë)	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i tokës bujqësore (arë) lekë/m²	Çmimi i ndërtimit lekë/m²	Vlera e tokës bujqësore (arë) lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e tokës bujqësore dhe e ndërtesës	Shënime
1	8330	4/223		Zoje Boka	225	0	34,068	0	7,665,300	0	7,665,300	
2	8330	4/224		Zoje Boka	1,147	0	34,068	0	39,075,996	0	39,075,996	
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT											46,741,296	